



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0789

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AAB CONSTRUCTION SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1, me 14.10.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserishte e bazuar ankesa e OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K. me nr. 2025/0789, e datës 18.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1.

2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Kuvendi i Komunës së Prishtinës., ndërkaq aktiviteti i prokurimit Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1 kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.03.2025 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €.

Me 02.08.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE NPT DAQA, NTP Lulishtja BUQAJ.

Me 08.08.2025, OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 09.08.2025.

Me 18.08.2025, OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0789, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik AAB CONSTRUCTION SH.P.K., lidhur me ankesën 0789/2025:

Të pakënaqur me njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i parkut në Hajvali me nr. të prokurimit: 616-25-1776-5-2-1, në afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë:

A N K E S Ë

Për shkak se AK- KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS: në mënyrë të kundërligjshme e ka shpallur të përgjegjshëm si dhe ka shpallur fitues kompaninë N.P.T. Daqa & N.T.P. Lulishtja Buçaj; në procedurën e prokurimit në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i parkut në Hajvali me nr. të prokurimit: 616-25-1776-5-2-1, ndërsa kompania në fjalë është e eliminuar, e ku do të sqarojmë edhe më poshtë:

Sqarojmë në mënyrë të detajuar: Autoriteti Kontraktues KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së.

Pavarësisht, në bazë të Rregullores 26.16 – Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme. Autoriteti Kontraktues, bazuar në nenin 69, 72 të

LPP-së, ka mundur që të kërkojë sqarim për dëshmitë e kërkuara si në kërkesë të DT dhe njoftimin për Kontratë. Për listën e projekteve, stafin profesional të lartcekur duhet të dorëzohen dëshmitë si në DT. Ku i gjithë dokumentacioni për të cilin jemi eliminuar ka mundur që të kërkohej në bazë të nenit 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, dokumente të cilat jemi të gatshëm edhe t'i prezantojmë konform njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Duke pasur parasysh, në bazë të ligjit, ne si Operator Ekonomik kemi ofruar çmimin më ekonomikisht të favorshëm për vlerësim, si dhe kemi paraqitur një periudhë garantuese për punët e kryera më të gjatë sesa Operator Ekonomik i cili është pretendues për nënshkrimin e kontratës, ne do të argumentojmë dhe specifikojmë edhe shkeljet dhe kërkesat që nuk janë përmbushur nga ana e Operatorit të përgjegjshëm dhe pretendues për nënshkrimin e kontratës, shkelje të cilat komisioni i vlerësimit nuk i ka evidentuar.

Shkeljet për të cilat N.P.T. Daqa & N.T.P. Lulishtja Buçaj është dashur që të eliminohet:

Në dosjen e tenderit, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 është kërkuar:

Për udhëheqësin e punishtes – si dëshmi është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme:

4.a) Udhëheqës i punishtes – Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, duhet të ketë dëshmi të punës në udhëheqje të kontratave të ngjashme në periudhën trevjeçare. Si dëshmi 2.a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar.

Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diplomën mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt. GOE N.P.T. Daqa dhe N.T.P. Lulishtja Buçaj nuk kanë dorëzuar deklaratën ku është emëruar menaxheri i projektit.

GOE duhet të ishte eliminuar nga procesi. Duke e pasur parasysh që kjo ka qenë edhe kriter i vlerësimit në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit. Mungon CV-ja e nënshkruar e inxhinierit. Kjo është një kërkesë e rëndësishme për vlerësimin e kandidatëve dhe duhet të sigurohet një dokument i tillë.

Referenca për punët e mëparshme: është specifikuar angazhimi i inxhinierit në projektet e kompanisë N.P.T. Daqa, mirëpo në CV të prezantuar për inxhinierin nuk është e cekur që ka punuar apo që ka qenë i angazhuar në projektet e kompanisë Daqa.

Duke pasur parasysh se nuk janë përmbushur kërkesat sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, është dashur që ky Operator Ekonomik të eliminohej nga procesi i vlerësimit.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që të ofrohet:

b) Inxhinier i diplomuar i industrisë së drurit së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Për pikat b), c), d) – Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diplomën mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme dhe kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt. Është prezantuar Certifikatë mbi kryerjen e studimeve në nivelin Bachelor e lëshuar në vitin

2009, ndërsa në dosjen e tenderit është kërkuar që të prezantohet Diplomë për këtë kërkesë.

Duke pasur parasysh se nuk janë përmbushur kërkesat sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, është dashur që ky Operator Ekonomik të eliminohej nga procesi i vlerësimit.

Në dosjen e tenderit është kërkuar: 5). OE duhet të ofrojë certifikatën për cilësinë e gomës dhe standardin e tyre EN 1177 + AC EN1176-1.

Kopjet e certifikatave të noterizuara, si dhe test-raportin që produktet e gomës të jenë antikancerogjene EN 771-3+A1 DIN 18035-7. Raportet e testimit të produkteve janë raporte të cilat nuk kanë përmbushur kriteret, pasi që raportet e prezantuara nuk janë në gjuhët zyrtare sipas ligjit të prokurimit publik, ku gjuhët zyrtare në prokurimin publik dhe dokumentet të cilat mund të prezantohen janë dokumentet në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, ndërsa i gjithë raporti i prezantuar është në gjuhën turke.

Duke pasur parasysh se nuk janë përmbushur kërkesat sipas Ligjit, Rregullores dhe Udhëzuesit të AK-së, ka qenë e nevojshme që ky Operator Ekonomik (GOE) të eliminohej nga procesi i vlerësimit.

Shihet qartë se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se: Autoriteti Kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Si dhe në pikën 2 thuhet: Autoriteti Kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomikë.

Duke pasur parasysh se nuk janë përmbushur kërkesat sipas Ligjit, Rregullores dhe Udhëzuesit të AK-së, ka qenë e nevojshme që ky Operator Ekonomik (GOE) të eliminohet nga procesi i vlerësimit. Me vendimin dhe sqarimet që kemi dhënë, shihet qartë se Komisioni i Vlerësimit ka shkelur deklaratën nën betim, në kundërshtim me nenet 1, 11 dhe 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092. Komisioni ka dështuar të zbatojë detyrën për të cilën ka nënshkruar deklaratën. Vlerësimi nuk është bërë në përputhje me ligjin, udhëzuesit dhe rregulloret përkatëse.

Ne, si kompani, me datën 08.08.2025 kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim. Kërkesë e cila është refuzuar në mënyrë të kundërligjshme nga ana e Autoritetit Kontraktues, me arsyetimin se është dorëzuar jashtë afatit. Megjithatë, kërkesa jonë është paraqitur duke u bazuar në Ligjin, Rregulloret dhe Udhëzuesit për Prokurimin Publik, konkretisht në nenin 5 – Kalkulimi i afateve kohore, ku përcaktohet qartë se afatet kohore fillojnë në një ditë pune dhe përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në orën 16:00.

Vendimi i marrë nga AK është lëshuar jashtë orarit të punës, përkatësisht në orën 16:24 (ditë e premtë). Duke u bazuar në ligjin e punës, llogaritja e afateve duhet të fillojë në një ditë pune dhe të përfundojë në një ditë pune. Prandaj, në këtë rast llogaritja duhet të fillojë ditën e hënë, pasi vendimi është marrë pas orarit zyrtar të së premtes. Në bazë të nenit 5, kalkulimi nuk mund të fillojë ditën e shtunë, sepse ajo nuk konsiderohet ditë pune dhe nuk mund të përfshihet në afatet kohore ligjore në këtë rast, ndërsa nëse ky vendim do të merrej po të njëjtën ditë (e premtë) brenda orarit të punës para orës 16:00 (orari zyrtar), atëherë dita e shtunë dhe e diel do të llogariteshin. Pra, sipas paragrafit 1 të nenit 5 të LPP-së, afatet kohore të këtij ligji duhet të

fillojnë në një ditë pune dhe përfundojnë në një ditë pune. Sipas këtij paragrafi dhe në shtjellim të mëtejshëm, ditë pune llogariten nga e hëna deri të premtën, ndërsa koha zyrtare e punës llogaritet nga ora 08:00-16:00. Për të gjitha rastet “Njoftimi mbi vendimin e AK-së” nënkupton njoftimin e ngritur në sistem nga AK para orës 16:00, në mënyrë që ajo ditë të konsiderohet dita “zero” e pesë (5) ditëve për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim.

Lidhur me çështjen, KRPP ka dhënë interpretim të cilin e ka publikuar në platformën e-prokurimi, në linkun: “informacione” në vegëzën **Interpretimet**, pyetja me numër 35 e datës 04.12.2023: *Si të kalkulohet afati kohor për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së?*

Me eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të OE i cili është i papërshtatshëm dhe i papërgjegjshëm, AK e ka favorizuar drejtpërdrejt OE-në e rekomanduar për kontratë, ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve drejtpërdrejt. Zyrtarët e AK me këtë vendim po tentojnë ta dëmtojnë buxhetin e Komunës, pasi kanë shpërblyer OE më të shtrenjtë sesa neve. Si dhe të keqmenaxhohen 98,652.00 € të buxhetit të Komunës. Pra, ne kemi dorëzuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm.

Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohen me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu shihet qartë se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, ku në pikën 1 thuhet se: Autoriteti Kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Ndërsa në pikën 2 thuhet: Autoriteti Kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomikë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik "AAB CONSTRUCTION" me datë 08.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut në Hajvali" me nr. të prokurimit 616-25-1776-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pas afatit. Përmes nenit 60 par. 1 nënpar. b) është përcaktuar se: “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontrate ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58) është dita (0).”

Në rastin konkret, njoftimi mbi vendimin është publikuar me datë 01.08.2025 pas orës 16:00, që llogaritet sikurse të jetë publikuar me datë 02.08.2025. Kjo nënkupton që data 02.08.2025 të jetë dita zero (0), ndërsa data e fundit kur kanë mundur të parashtrohen kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin ka qenë data 07.08.2025 deri në ora 16:00.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e dt. 08.08.2025 është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin b) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si e palejuar, përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1 paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) dhe nenin 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2 të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 21.08.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0789, ndërsa me datë 03.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0789. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0789, ka vlerësuar si në vijim:

Operatori ekonomik nuk i ka të ndara pretendimet ankimor mirëpo për qëllim të trajtimit të ankesës ne i kemi renditur si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor 1.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr 1 thekson se është eliminuar nga AK-Komuna e Prishtinës si në vijim:

OE Ankues thëkëson Autoriteti Kontraktues bazuar ne nenin 69, 72 të LPP-se ka mundur që të kërkoj sqarim për dëshmitë e kërkuara si ne kërkesë të DT dhe njoftimin për Kontratë, Për listën e projekteve, stafin profesional të lartcekur duhet te dorëzohen dëshmitë si ne DT. Ku i gjitha dokumentacioni për të cilin jemi eliminuar ka mundur që të kërkojen në bazë të Nenit-72-Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, dokumente të cilat jemi të gatshëm edhe ti prezantojmë konform njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se bazuar ne nenin 72 pika 3 te LPP-së i cili thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj ne përputhje me këtë paragraf rekomandojm qe AK-Komuna e Prishtines ka mundur te kërkoj sqarimet shtesë tek Operatori Ekonomik ankues , i cili ka dorëzuar njeherit edhe ofertën me te lirë se operatori ekonimk i rekomanduar per kontratë.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 1 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor pjesërisht te bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 2.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr 2 thekson se është eliminuar nga AK-Komuna e Prishtines si ne vijim:

GOE N.P.T. Daqa dhe N.T.P. Lulishtja Buçaj nuk kanë dorëzuar Deklaratën ku është emëruar menaxheri i projektit. GOE duhet të ishte eliminuar nga procesi. Duke e pasur parasysh që kjo ka qenë edhe kriter i vlerësimit në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne dosje te tenderit një kërkesë e tillë është kërkuar tek dëshmia si me poshtë:

2. a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar. Te dëshmohet me CV'n e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin , referenca për punët e mëparshme. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt. Për pikat b), c), d), - Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca per punët e mëparshme dhe kontrata e punes me punedhenesin ose marrveshje per ketë projekt.

Eksperti shqyrtues sqaron se një deklaratë e till mbi emërimin e menaxherit te kontratës mungon ne ofertën e OE te rekomanduar per kontratë, mirëpo sipas kërkesës per sqarime shtesë te datës 14.07.2025 rezulton se AK-Komuna e Prishtines ka kërkuar sqarimet edhe ne lidhje me deklaratën mbi emërimin e menaxherit te kontratës dhe pas kërkesës sonë per sqarime tek AK-me datë 03.09.2025 kemi pranuar sqarimet e ofruara nga OE i rekomanduar per kontratë dhe ne mesin e tyre gjendet edhe deklarata mbi emërimin e menaxherit te projektit. Emerimi i menaxherit te kontratës është obligative sepse kërkohet nënshkrimi edhe ne fazat e mëvonshme te ekzekutimit te kontratës duke filluar edhe nga Plani i Menxhimit te Kontrates (PMK) qe duhet te përgatitet nga te dy menaxheret e kontratave (AK dhe OE) andaj mbetet ne përgjegjësin e AK-Komuna e Prishtines nëse një dokument i tillë i pranuar është ne harmoni me paragrafin 3 te nenit 72 te LPP-se sepse ekzistenca e tij para dorëzimit te tenderëve nuk mund te vërtetohet saktësisht.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 2 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor pjesërisht te bazuar.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 3 thekson se është eliminuar nga AK-Komuna e Prishtines si ne vijim:

Mungon CV-ja e nënshkruar e inxhinierit. Kjo është një kërkesë e rëndësishme për vlerësimin e kandidatëve dhe duhet të sigurohet një dokument i tillë. Duke e pasur parasysh që kjo ka qenë edhe kriter i vlerësimit në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar per kontratë ka te nënshkruar kontratën me inxh, e ndërtimtarisë për anagazhim ne këtë aktivitet te prokurimi andaj kjo nënkupton qe palët janë pajtuar per angazhim ne këtë projekt nga inxhinieri përkatës i ndërtimtarisë. Mos nënshkrimi i CV-se nga inxhinieri edhe pse ka qenë kërkesë e dosjes se tenderit rekomandoj te trajtohet si devijim i vogël sipas nenit paragrafit 2 te nenit 59.4 te LPP-se i cili thotë, citat paragrafi:

“Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 3 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor te pa bazuar.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 4 thekson si ne vijim:

Referenca për punët e mëparshme është specifikuar angazhimi i Inxhinierit në projektet e kompanisë N.P.T Daqa mirëpo, në CV të prezantuar për inxhinierin, nuk është e cekur që ka punuar apo që ka qenë i angazhuar në projektet e kompanisë Daqa.

Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa dhe dëshmia ne dosje te tenderit ne lidhje me këtë pretendim ankimor është:

2. a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar. Te dëshmohet me CV'n e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin , referenca për punët e mëparshme. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt. Për pikat b), c), d), - Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca per punët e mëparshme dhe kontrata e punes me punedhenesin ose marrveshje per këtë projekt.

Sqarojm se ne Leter Referencen e lëshuar nga OE NPT DAQA “Nexhmedin Sadiku” B.I , per Inxhinierin ceken nje numër i madh i projekteve ne te cilat inxhinieri përkatës ka punuar ne projektet e këtij operatori ekonomik andaj si e tillë OE dhe inxhinier mbajn përgjegjegjesin për vëtetesin e tyre.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 4 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor te pa bazuar.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 5 thekson si ne vijim

Në dosjen e tenderit është kërkuar që të ofrohet b) Inxhinier i diplomuar i industrisë së drurit se paku 3 vite pervoj pune pas diplomimit. Për pikat b), c), d), - Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme dhe kontrata e punës me punedhënesin ose marrveshje për këtë projekt.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka përfshirë në dosje të tenderit certifikatën e inxhinierit të industrisë së drurit mbi përfundimin e studimeve themelore bachelore.

Bazuar në faktin se në dosje të tenderit AK-Komuna e Prishtinës nuk ka të kufizuar numrin e kerdive që duhet të i ketë një diplomë e tillë andaj nuk mund të refuzohet në këto raste diploma e nivelit bachelor.

Bazuar në përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 5 konstatojmë se kemi të bëjmë me pretendim ankimor të pa bazuar.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 6 thekson si ne vijim

Në dosjen e tenderit është kërkuar: 5). OE duhet të ofroj certifikatën për cilësinë e gomes dhe standardin e tyre EN 1177 + AC EN1176-1 5. Kopjet e certifikatave të noterizuara si dhe test raportin që produktet e gomes të jenë antikancerogjene EN 771-3+A1 DIN 18035-7 Raportet e testimit të produkteve janë raporte të cilat nuk kanë përmbushur kriteret pasi që raportet e prezantuara nuk janë në gjuhët zyrtare sipas ligjit të prokurimit publik, ku gjuhët zyrtare në prokurimin publik, dhe dokumentet të cilat mund të prezantohen dokumentet janë në gjuhën Shqipe, Angleze dhe Serbe, ndërsa i gjithë raporti i prezantuar është në gjuhën turke.

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas Neni 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, përkatësisht paragrafi 4 i këtij neni thotë: Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.

Po ashtu në lidhje me përdorimin e gjuhëve në aktivitete të prokurimit publik kemi edhe opinionin e KRPP-se të datës 22.06.2023, si ne vijim:

13. 22.06.2023 Si duhet të veprojnë AK, në rast se një tenderues paraqet ndonjë dokument të tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së?

Konform neni 87, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron këtë:

OPINION

Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton:

“Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”.

Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përshkruhet në dokumentet standarde të tenderit.

Sipas dispozitës së lartpërmendur, tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur.

Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së.

Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësoj tenderin.

Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim:

1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht;

2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze.

Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike.

Pra, sjellja e dokumenteve në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë e OE.

3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit.

Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.

4) Parimi i lartpërmendur mund të ketë një shmangie kur nuk ka të bëjë me pjesë thelbësore të tenderit, si për shembull broshura, anekse ose dokumente të tjera që kanë karakter jo të detyrueshëm, por thjesht dorëzohen nga OE për të përshkruar më mirë produktin e ofruar.

Specifikimet teknike pjesë thelbësore e tenderit, prandaj, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet.

Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument.

Bazuar ne paragrafin e fundit te interepimitit te KRPP-se i cili thotë se per cilin document qe kërkohet si dëshni sipas nenit 65-71 te LPP-së , ne pepruthje me nenin 72 te LPP-se mund te kërkohet nga OE te drezoj një perkthim zyrtar te te njejtis dokument.

Andaj nga përshkrimi I mesiperm rekomandojm qe AK-Komuna e Prishtines ne fazen e rivleresimit te veproj ne pepruthje me nenin 72 te LPP-se dhe te kerkoj perkthimin e këtij dokumenti ne njëren nga gjuhete e lejuara sipas nenit 13 te Ligjit per prokurim public.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 6 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor pjesërisht te bazuar.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 7 thekson si ne vijim:

Në dosjen e tenderit është kërkuar: _11). OE duhet të ploteso planin dinamik për përfundimin e punimeve. Plani dinamik i nënshkruar dhe i vulosur nga OE, sipas mostrës se ngarkuar nga autoriteti kontraktues.

GOE ka prezantuar një plan dinamik ku janë specifikuar punimet do të zhvillohen në 12 jave -që i bie që janë 84ditë, Ndërsa në dosjen e tenderit është specifikuar 5.2-Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: 60 ditë.

Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa e AK-Komuna e Prishtines në dosje te tenderit është:

Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: 60 ditë.

Në bazë te formulimit te fjalisë ne dosje te tenderit nuk mund te konstatohet nëse AK, ju ka referuar afateve kohore si ditë pune apo dit kalendarike andaj operatori ekonomik i rekomanduar per kontratë ka plotësuar planin dinamik te kryerjes se punëve për 60 ditë pune. Një gjë e tillë është në përgjegjësin e AK-se respektivisht menaxherit te kontratës qe te mbikëqyr zbatimin e planit dinamik ne fazën e ekzekutimit te kontratës nëse OE i rekomanduar per kontratë do te i përmbahet planit dinamik qe vetë ka prezentuar.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 7 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor te pa bazuar.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 8 thekson si ne vijim

Në aneksin 8-Deklarata per themelimin e grupit, është kërkuar që deklaratat të nënshkruhen nga secili anëtar i grupit apo kozorciumi që aplikon, ndërsa deklarata nuk është nënshkruar nga ana e anëtarit tjetër sipas kërkesës në Aneksin 8.

Eksperti shqyrtues sqaron se i njëjti dokument Ankesi 8 mbi Themelimin e Grupit te operateve ekonomik është i nënshkruar ne faqen 3 mirëpo mungon nëshkrimi ne faqen 1 mirëpo ka vulën e Operatorit ekonomik i cili ka nënshkrur dokumentin ne faqen 3.

Bazuar ne përshkrimin e mësipërm rekomandojm qe AK-se ne fazën e rivlerësimit te kerkoj sqarimet sipas nenit 72 te LPP-se dhe te konfirmoj tek Operatori Ekonomik te cilit i mungon nëshkrimi nëse qëndron mbrapa Themelimit te Grupit te Operatoreve ekonomik.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 8 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor pjesërisht te bazuar.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 9 thekson si ne vijim:

Në dosjen e tenderit është kërkuar që të prezantohen certifikatat. ISO-9001-2015, ISO-14001-2015, ISO-45001-2018, ISO-39001-2012, Çertifikatat ISO janë ofruar vetem nga lideri i grupit, mirëpo nuk ka paraqit ISO standardet dhe per anëtarin e grupit, duke u bazuar ne Rregulloren Nr.001/2023 për Prokurim Publik.

Eksperti shqyrtues sqaron se Rregullorja e KRPP-së nr 001/2022 , plotësim ndryshimi i saj përmes Rr, nr 002/2024 te hyrë ne fuqi me datë 11.11.2024 e trajton këtë çështje si ne vijim:

26.6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përputhshmërinë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Në rast të kontratave për furnizime, punë, shërbime, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.

Ne këtë rast kemi te bëjmë me kontratë të punëve qe është brenda fushëveprimit te nenit 26.6 te Rr. PP te lardekur dhe sipas këtij neni certifikata per përmbushje te standardeve përkatëse duhet te oforhen nga secili anëtar i grupit.

Theksojm se AK-ne Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre.

Bazuar ne përshkrimin e mësipërm dhe sipas nenit 26.6 te Rr. PP nr 001/2022 dhe plotësim ndryshimi përmes Rr,nr 002/2024 rekomandojm se AK-Komuna e Prishtine ne procedurën e rivlerësimit te kërkoj informata shitesë sipas nenit 72.3 te LPP-se dhe nenit 38 te Rregullores per Prokurim Publik. Rekomandimin e mbështesim ne faktin se ISO Standardet janë dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive nëse janë lëshuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 9 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor te bazuar.

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 10 thekson si ne vijim:

Ne, si kompani, me datën 08.08.2025 kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim. Kërkesë e cila është refuzuar në mënyrë të kundërligjshme nga ana e Autoritetit Kontraktues, me arsyetimin se është dorëzuar jashtë afatit. Megjithatë, kërkesa jonë është paraqitur duke u bazuar në Ligjin, Rregulloret dhe Udhëzuesit për Prokurimin Publik, konkretisht në Nenin 5 – Kalkulimi i afateve kohore, ku përcaktohet qartë se afatet kohore fillojnë në një ditë pune dhe përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00.

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas interpretimit te KRPP-se nr. 35. 04.12.2023 Si te kalkulohet afati kohor për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së?, i cili gjendet ne web faqen zyrtare te E-prokurimit , shih linkun: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=544>.

Citat interpretimi: Në përputhje me nenin 60.1, b) të RRPP Në rast se AK ka publikuar në platformën elektronike të prokurimit publik B58 “Njoftimin mbi Vendimin e AK-së”, data e publikimit të këtij njoftimi është dita “zero” e pesë (5) ditëve për parashtrimin e një Kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Për shembull: Nëse B58 “Njoftimi mbi vendimin e AK-së” është publikuar me datë 20.10.2023 para orës 16:00. Afati fillon të kalkulohet nga dita e nesërme e publikimit: 21. 22. 23. 24. 25 dhe rrjedhimisht afati i fundit për të parashtruar Kërkesën për rishqyrtim është data 25.10.2023 deri në ora 16:00. Pra nëse AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK-së në ditën e premte, dita e premte është dita “0” e pesë (5) ditëve për Kërkesë për rishqyrtim në AK. Pra afati i fundit për të parashtruar kërkesën është dita e Mërkurë deri në ora 16:00.

Po ashtu paragrafi tjetër i interpretimi të KRPP-se vazhdon në vijim:

Për të gjitha rastet “Njoftimi mbi vendimin e AK-së” nënkupton Njoftimin e ngritur në sistem nga AK para orës 16:00 në mënyrë që ajo ditë të konsiderohet dita “zero” e pesë (5) ditëve për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim. Operatorët Ekonomik dhe/ose palët e interesuara do të konsiderohen “Të njoftuar” nga momenti kur AK e ngritë në sistem cilin do njoftim lidhur me aktivitetin në fjalë. Çdo Kërkesë e parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 60 të RRPP, do të refuzohet nga AK dhe për të njëjtën ankesa nuk do të merret në shqyrtim nga OSHP.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në interpretimin e lartcekur të KRPP-së të datës 04.12.2023 thekson se “Njoftimi mbi vendimin e AK-së” nënkupton Njoftimin e ngritur në sistem nga AK para orës 16:00 në mënyrë që ajo ditë të konsiderohet dita “zero” e pesë (5) ditëve për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim. Nga kjo rezulton se dita zero konsiderohet vetëm nëse njoftimi ngritët para orës 16:00 të ditës përkatëse. Edhe pse interpretimi i KRPP-se nuk i referohet nëse njoftimi ngritët ditën e Premte pas orës 16:00 se cila ditë duhet të konsiderohet ditë zero e pesë (5) ditëve për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim theksojmë se duke ju referuar nenit 5 të LPP-se dhe interpretimit të KRPP-se pasi që njoftimi është ngritur pas orës 16:00 dita e Shtunë në këtë rast nuk mund të konsiderohet dita zero.

Andaj bazuar në përshkrimin e mesiperm, nenin 5 të LPP-se, interpretimin e KRPP-se edhe në faktin se OSHP ka marrë në shqyrtim ankesën rekomandojmë që ky pretendim ankimor është i bazuar dhe AK Komuna e Prishtinës duhet të trajtoj kërkesën për rishqyrtim të bërë nga OE ankues me datë 08.08.2025.

Bazuar në përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 10 konstatojmë se kemi të bëjmë me pretendim ankimor të bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Bazuar në përshkrimin e bërë me sipër, pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, dosjes së tenderit, dallimin në çmim në mes OE të rekomandur dhe OE ankues, nenit 6 të LPP-së rekomandojmë Panellin Shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të anulohet vendimi i AK-së mbi dhënien e kontatës i datës 31.07.2025

dhe lënda te kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar, të anulohet B58,, Njoftim mbi vendimin e AK-se” lidhur me aktivitetin me titull Ndërtimi i parkut në Hajvali me nr. të prokurimit: 616-25-1776-5-2-1, ndërkaq lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AAB CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: